



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1600/ 13 prot.

Datë 31 .07.2026

VENDIM
Nr. 897 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gjergj Mersini	Nënkryetar
Nertil Kanina	Anëtar
Edvin Simo	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.817/2026, datë 17.06.2026 për procedurën e prokurimit, prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.

Ankimues: Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” sh.p.k, me Nipt, K71820009I, dhe adresë: *Rruga Tish Dahia, Kompleksi Kika 2, Pallati nr.9, Kati 8 , Tirane, Tirana.*

Operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF, me NIPT (L61608005C) dhe adresë: *Rruga Muhamet Veliu, Pallati 3D ,Njesia me nr.Pasurie 475/103-G15, ZK:2460.*

Operatori ekonomik “Zeqiri” shpk, me Nipt, J67902827A, dhe adresë: *Lagjja Bishanak, Rruga Skenderbeu, Zona Kadastrale 5532, Banese private , Pasuria nr. 1/1088, Kati.*

Autoriteti Kontraktor: Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh, me adresë: *Lagja 13, Rruga: Dhimiter Kraja.*

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “Luar Bros” shpk, me NIPT L72322004M dhe adresë: Rruga Ali Demi , Kompleksi Vind, Shkalla B, Kati 4, Apartamenti 11.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar , Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 17.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.817/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Malvina Visoka” pf në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Leon Konstruksion” shpk në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.
3. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Zeqiri” shpk në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.
4. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “Leon Konstruksion sh.p.k dhe “Zeqiri” shpk duke i kualifikuar atë sipas konstatimeve të këtij vendimi.
5. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “Luar Bros” shpk, duke e skualifikuar sipas këtij vendimi.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK.
7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Zeqiri ” SHP

8. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Malvina Visoka” pf.
 9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.375 prot., datë 30.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1610/10 prot., date 02.07.2026, autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh, njofton se ka bërë zbatimin e vendimit duke bërë rivlesimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurë objekt ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.375 prot., datë 30.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1610/10 prot., date 02.07.2026, autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh, njofton se ka bërë zbatimin e vendimit duke bërë rivlesimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurë objekt ankimi.

II.2. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se referuar verifikimeve në sitemin elektronik si dhe raportit të auditit, konstaton se autoriteti kontraktor Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh, ka zbatuar vendimin Nr. 817/2026, datë 17.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81658-04-10-2026, me objekt “Blerje kazan plastik”, me fond limit 5,000,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja Sherbimeve Komunale Plazh.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Nënkryetar
Gjergj Mersini